



KONTRATE

PER THEMELIMIN E SHOQERISE TREGTARE

“T.D.T.”Shpk

NDERMJET :

- 1- Petrit ISMAILI, i biri i Nikes, lindur ne Bajram Curri me 02.12.1963 dhe banues ne Tirane, Rruga “Mine Peza”, Nr.220.
- 2- Dashnor MUSTAJ, i biri i Bajramit, lindur ne Bajram Curri me 08.03.1961 dhe banues ne Tirane, Rruga “Mine Peza”, Nr.220.
- 3- Petrit PREBIBAJ, i biri i Franit, lindur ne Bajram Curri me 30.05.1962 dhe banues ne Tirane, Rruga “H.H.Dalliu”, Nr.32.

Te tre te lartepemendurit kane rene dakort qe te krijojne nje Shoqeri Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, konforme vullnetit te tyre te lire dhe ne baze te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 “Per Shoqerite Tregtare”, Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 “Per Regjistrin Tregtar” si dhe Ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 “Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private dhe nismes se lire, veprimtarise private dhe privatizimit” si me poshte :

Neni 1

Te themelojne nje Shoqeri Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar per te ushtruar veprimtari ekonomike e private te emertuar : “T.D.T.”Shpk

Neni 2

Kjo Shoqeri Tregtare do te kete seline e saj ne Tirane, “Mine Peza”, Nr.220.


Neni 3

Periudha e veprimtarise se Shoqerise do te jete 10 vjet dhe gjendja e saj juridike percaktohet nga momenti i themelimit dhe regjistrimi i saj ne gjykatën kompetente.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise Tregtare “T.D.T.”Shpk, do te jete ne fuishen e :

- Germime dheu me punime eventuale murature e beton arme-prishje dhe punime ne toke te germuar.
- Prodhim materiale inerte-gure.
- Prodhim elemente betoni e betonarme te zakonshme-paranderur-gure dekorativ.
- Ndertime civile-industriale-turistike-bujqesore, deri ne 5 kate.
- Ndertime civile-industriale-turistike-bujqesore mbi 5 kate-rikonstruksione.
- Ndertime banesa me skelet mbi 8 kate.
- Ndertim rruge kategoria 4 dhe 5.
- Ndertime rruge kategoria 3, dhe 2-1.
- Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbishtresa rrugore.
- Ndertim ura dhe vepra arti deri ne 10 m.

- 
- Ndertim ura dhe vepra arti mbi 10 m-Eskada-ura metalike-te varura.
 - Ndertim ujsjelles-kanalizime-kanale e impiante vaditje.
 - Punime mbrojtje te sistemit hidraulik-çimentime.
 - Villosa, kulla, kulla uji etj prej b/arme-metalike.
 - Perforcim themeli e punime nen tokesore.
 - Izolime mbi dhe nen tokesore nga ujrat.
 - Themele te veçanta.
 - Punime karpentjerie druri.
 - Instalimi i impianteve higjenike, kuzhina,lavanteri,hidrosanitare-mirembajtja e tyre.
 - Instalimi i materialeve prej druri-metalike-plastike-xhami.
 - Punime bojatisje-hidroizolim-termoizolim-akustike-kundra zjarrit.
 - Punime elektrike dhe instalime.
 - Projektim objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate.
 - Projektim instalim hidrosanitare.
 - Projektim rruge auto categoria 4 dhe 5.
 - Projektim ura dhe vepra arti deri ne 10.
 - Pastrim i siperfaqes urbane.
 - Kryerja e punimeve ne sherbesa funerale.
 - Tregtim i armene te gjahut, municioneve dhe pjeseve te tyre.
 - Autoshkolle dhe shkolle private e kopshte.
 - Tregtimin me shumice e pakice te artikujve te ndryshem te import eksportit si industriale, ushqimore, paisje elektroshtepiake dhe elektronike, automjete dhe pjese kembimi per to, karburante e lubrificante, materiale adertimi dhe elektrike, konfeksione dhe kinkaleri, vegla pune dhe paisje per pune, cigare dhe pije alkolike, transporti i pasagjereve dhe mallrave brenda dhe jashte vendit tone, krijimi i agjensive turistike brenda dhe jashte vendit.

Neni 5

Shoqeria ne baze te legjislacionit shqiptar ka te drejte te hapi filiale, dege, perfaqesi dhe te jape perfaqesimin ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do te hapen.

Neni 6


Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 100.000 Leke.

Ky kapital eshte i ndare ne 100 pjese ku njera pjese eshte e barabarte me 1.000 leke dhe kuotat e secilit ortak jane si me poshte :

- 1) Petrit ISMAILI merr 33.3% te kapitalit.
- 2) Dashnor MUSTAJ merr 33.3 % te kapitalit.
- 3) Petrit PREBIBAJ merr 33.3 % te kapitalit.

Neni 7

Kapitali themeltar i Shoqerise sipas nenit 5 te kesaj kontrate perfaqeson kapitalet e derdhura nga sejcili Ortak te nevojshme per veprimtarine e Shoqerise. Sipas kerkeses se Ligjes Kapitali Themeltar do te depozitohet ne nje nga Bankat e Shtetit Shqiptar ose ne nje





nga Bankat e tjera qe jane hapur ose do te hapen ne te ardhmen ne Shqiperi, te njohura nga Shteti Shqiptar Kapitali Themeltar mund te jete i shprehur edhe ne natyre vleresimi i te cilit do te jete sipas legjislacionit te dale per kete qellim.

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne shoqerine tregtare do te shenohet edhe kapitali i derdhur nga çdo Ortak. Rritja e kapitalit te Ortakeve nuk eshte i kufizuar.

Neni 8

Shoqeria Tregtare ne maredheniet me te tretet pergjigjet vetem me pasurite e shoqerise, fondet e saja dhe Ortaket pergjigjen per detyrimet e kesaj Shoqerie vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 9

Shoqeria pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit te percaktuar ne kete kontrate ose per shkaqe te perligjura qe gjykohen te tilla nga Ortaket.

Fitimi neto ndahet sipas pjeseve te kontributit per krijimin e Kapitalit Themeltar.

Neni 10

Organet drejtuese te Shoqerise jane :

- Asambleja e Ortakeve.
- Administratori.

Administrator i shoqerise do te emerohet Z.Petrit ISMAILI.

Modalitetet per perberjen dhe funksionimin e organeve te mesiperme percaktohen nga Statuti i Shoqerise si dhe nga Ligji "Per Shoqerite Tregtare".

Neni 11

Ortaket jane te detyruar te ruajne sekretin e dokumentacionit, informacionit, njohjeve dhe eksperiences se kembyer e te realizuar brenda Shoqerise dhe te marrin te gjitha masat per te evituar perhapjen e tyre qofte dhe ne menyre te pjeseshme.

Ortaket jane pergjegjes per pasojat e demshme, te shkeljeve ndaj ligjit per Shoqerite Tregtare.

Neni 12

Kjo kontrate eshte e vlefshme per nje periudhe 10 vjeçare.

Shoqeria mund te shperndahet edhe para ketij afati ne baze te vendimit te Asamblese se Ortakeve.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarreshjeve do te behet konform normave te konventave nderkombetare per rregullimin e mosmarreshjeve ne Shoqerite Tregtare, ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane ose ndonje Gjykate Nderkombetare.

Neni 14

Dispozitat me te detajuara per Shoqerine "T.D.K." Shpk jane percaktuar dhe permbahen ne Statutin e saj.


Neni 15

Kjo kontrate formulohet ne kater kopje, nga te cilat njera depozitohet ne Zyren e Noterise Tirane, njera depozitohet ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, njera ne Zyren e Tatimeve Tirane dhe kopja e katert mbahet ne dokumentat e Shoqerise.


Kontrata eshte e vlefshme qe nga momenti i nenshkrimt te saj nga te dy Ortaket.

O R T A K E T

Petrit ISMAILI



Dashnor MUSTAJ



Petrit PREBIBAJ

